

UDHËZIM
Nr. 3919, datë 18.7.2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 20, DATË 10.10.2007,
“PËR MODELET E LICENCEVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR” TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 5 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 20, datë 10.10.2007, “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në hyrje të udhëzimit, togfjalëshi:

- a) “ligjit nr. 8653, datë 31.7.2000, “Për ndarjen administrative të Republikës së Shqipërisë” zëvendësohet me togfjalëshin “ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësjive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;
- b) “ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për qeverisjen vendore” zëvendësohet me togfjalëshin “ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- c) “Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” zëvendësohet me togfjalëshin “Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës”.

Neni 2

Modeli nr. 208 i certifikatës në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus për shërbimet në linjë të rregullt/të rregullt të specializuar/për shërbimet vajtje-ardhje zëvendësohet me modelin bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 3

Modeli nr. 306 i librit të udhëtimit për shërbimet e rastit të udhëtarëve brenda vendit shfuqizohet. Për këtë shërbim zbatohet modeli bashkëlidhur udhëzimit nr. 8885, datë 7.11.2016, “Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Republic of Albania
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Ministry of Transport and Infrastructure
DREJTORIA E LICENCIMIT
DIRECTORATE OF LICENCES

CERTIFIKATË
Certificate

Nr. _____, datë ____/____/____
 No _____, date

**NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS PËR
 SHËRBIMET NË LINJË TË RREGULLT / TË RREGULLT TË
 SPECIALIZUAR / PËR SHËRBIMET VAJTJE-ARDHJE¹**
(In the international transport of passengers by bus, for regular line service / for regular specialized service / for shuttle service)

I LËSHOHET AUTOBUSIT:
Issued to the bus:

Targa: _____
Number plate

Tipi: _____
Type

Në përdorim të personit juridik: _____
To be used by the juridical person:

Sipas licencës: nr. _____ date ____/____/____
Based on the License No _____, date

Sipas autorizimit/ve: nr. _____ date ____/____/____
Based on the Authorization/s No _____, date

Certifikata është e vlefshme deri më datën ____/____/____
The Certificate is valid until

Firma dhe vula
Signature and Stamp
e autoritetit kompetent
of the Competent Authority

¹ Hiqen të panevojshmet. Përdoret vetëm emërtimi i linjës të cilës i përket licenca: të rregullta të specializuara ose vajtje-ardhje.

1. Linja:
Journey

Itinerari me stacionet e nënvizuara:
Itinerary with the pick up and set down point underlined

- a) vendi i nisjes të shërbimit:
Point of service departure
b) vendi i destinacionit të shërbimit:
Point of service destination

Frekuenca:
Frequency

2. Linja:
Journey

Itinerari me stacionet e nënvizuara:
Itinerary with the pick up and set down point underlined

- a) vendi i nisjes të shërbimit:
Point of service departure
b) vendi i destinacionit të shërbimit:
Point of service destination

Frekuenca:
Frequency

3. Linja:
Journey

Itinerari me stacionet e nënvizuara:
Itinerary with the pick up and set down point underlined

- a) vendi i nisjes të shërbimit:
Point of service departure
b) vendi i destinacionit të shërbimit:
Point of service destination

Frekuenca:
Frequency

4. Linja:
Journey

Itinerari me stacionet e nënvizuara:
Itinerary with the pick up and set down point underlined

- a) vendi i nisjes të shërbimit:
Point of service departure
b) vendi i destinacionit të shërbimit:
Point of service destination

Frekuenca:
Frequency

(Vula e autoritetit kompetent që e lëshon)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

(General Provisions)

1. Transportuesi është i detyruar të zbatojë dispozitat ligjore në fuqi në territorin e palës tjetër kontraktuese, në veçanti ato që lidhen me transportin dhe qarkullimin.
(The carrier is obligated to apply of the law in force in the territory of the other contracting party, particularly with regard to transport and traffic).

2. Ndalohet transporti i udhëtarëve nga një origjinë në një destinacion brenda territorit të palës tjetër kontraktuese.
(It is forbidden the carriage of the passengers from a point to another point in the territory of the other contracting party).

3. Kjo certifikatë është e vlefshme për kryesjen e transporteve ndërkombëtare të udhëtarëve me autobus në linjë të rregullt ose të rregullt të specializuar, ose (vajtje-ardhje) në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus.
(This certificate is valid for regular line service, or for regular specialised service, or for shuttle service in the international carriage of passengers by bus).

4. Certifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullar) i saj te një subjekt tjetër.
(This certificate is personal and non-transferable).

5. Certifikata është e pavlefshme, kur:
(The Certificate is no longer valid, when):

- a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;
(The term of validity is over);
- b) në të mungojnë ose janë bërë të palexueshme:
(In it are either missing or no more legible the following specifications):
 - emri i shoqërisë, targa e mjetit;
(The name of company, number plate);
 - nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent;
(The signature and stamp of the Competent Authority);
 - data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.
(The starting and the ending date of the validity time period).

6. Certifikata hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
(The Competent Authority who has issued the Certificate withdraws it, when):

- a) provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e certifikatës;
(It is proved that the carrier has presented either incorrect or false information related to the data requested for issuing the license);
- b) hiqet licenca/ autorizimi në bazë të së cilës ajo është lëshuar.
(The licence, on the basis of which it is issued, is withdrawn).

7. Certifikata në origjinal mbahet në mjet gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet menjëherë organeve të kontrollit me kërkesën e tyre.
(The original of the certificate must be kept on the board of the vehicle and must be presented at the request of any inspecting officer).

8. Afati i vlefshmërisë së certifikatës në asnjë rast nuk duhet të kalojë afatin e vlefshmërisë së autorizimit.
(The term of validity of certificate in neither case mustn't exceed the term of validity of authorization).